



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2019:197663

Datë: 17.10.2019

Numri i dokumentit: 00585131

P.nr.433/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE-DEGA SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mentor Hajraj dhe procesmbajtësen Aferdita Isufi, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit K.S. nga K. komuna e S., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2, lidhur me par. pika 1.4 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.1368/2019, të dt. 02.09.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të dt.14.10.2019, i cili ishte publik e verbal, në të cilin ishin prezent prokurorja e shtetit Daniella Batkoviç, i pandehuri K.S.dhe përkthyesi i gjykatës Shaban Hajra, të njëjtën ditë e mori dhe publikisht e shpalli, ndërsa me dt.17.10.2019 e përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari **K.S.**, i biri i A. dhe H. e vajzërisë Ç., i lindur me dt. *data e lindjes...*, në S., me vendbanim në fshatin K., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal: *numri personal...*

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me dt.27.07.2018, rreth orës 00:45 minuta, në S., në Rr." S.", i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D.D., në atë mënyrë që për shkak të grindjes në lokalin afarist-kafenen "A.", në të cilën i dëmtuari ka punuar si kamarier, e ka pritur të njëjtin pas përfundimit të ndërrimit është nisur për në shtëpi në këmb dhe i ka dal përpara me automjetin e tij të markës "BMW" të rexhistrimit gjerman, ka hipur në trotuar dhe e ka goditur me retrovizor, e pastaj ka dal nga automjeti e ka marr një shufër metalike dhe ka filluar që me të njëjtën ta godas të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit, kokës, në duar por ka ndërhyrë A.T. i cili i ka ndarë, i dëmtuari me këtë rast ka pësuar lëndime të lehta trupore në forme të ndryshme të indeve të buta të kokës dhe shpinës si dhe plagë shqyese në tepen e kokës nga ana e majtë të cilat paraqesin pengës të përkohshme për shëndetin.

Me këtë ka kryer veprë penale – Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të se njëjtës dispozite ligjore si dhe neneve 41, 46, 73, 75 dhe 76 të KPRK-së, e lidhur me nenet 450 par.2 nenparag.2.6, 453 par.1, 463 par.1 dhe 2 dhe neni 365 të KPP-së, të akuzuarin, e:

G J Y K O N D Ë N I M M E G J O B Ë

- Të akuzuarit gjykata i shqipton dënim me gjobë në lartësi prej **400 (katërqind) euro**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 30 ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata atëherë ky dënim do t'i zëvendësohet në bazë të nenit 46 par.3 të KPRK-së.
- Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20€ (njëzet euro), ndërsa në emër të paushallit gjyqësor obligohet të paguaj shumë prej 10 (dhjet) euro, të cilat është i obliguar që t'i paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- Pala e dëmtuar D.D., nga fshati K., Rr."T.", komuna e S., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Dep.i Përgjithshëm me aktakuzën e saj PP.II.nr.1368/19, të dt.02.09.2019, e ka akuzuar K.S. nga K. komuna e S. për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjykata në këtë çështje penale me dt.14.10.2019, e ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin shqyrtim aktakuzën në këtë gjykatë e përfaqësoj prokurori i shtetit pranë Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm Daniella Batković.

Në këtë shqyrtim fillestar gjykata e njoftoj të akuzuarin K.S.me të drejtat e tij procedurale, i njëjti deklaroi së i ka kuptuar të drejtat e tij sa i përket mbrojtësit deklaroi së dëshiron të mbrohet vet.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, gjykata të akuzuarin K.S.e ka njoftuar hollësisht me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar së i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë e me pas u deklarua se e pranon fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale për të cilën i vihet në barrë sipas aktakuzës, njëherësh shprehu keqardhje

për rastin që i ka ndodhur, i premtoj gjykatës së në të ardhmen nuk do t'i përsërit veprimet e tilla.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, gjykata e kërkojë mendimin nga prokurori i shtetit, e cila me këtë rast deklaroi së i akuzuari pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare pa imponime, ky pranim i fajësisë ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe i propozoj gjykatës që ta aprovoj këtë pranim fajësie.

Pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari dhe pas marrjes së mendimit nga prokurori i shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues në bazë të dispozitës ligjore nga neni 248 paragraf 4 lidhur me par. 1 të KPP-së, ka marrë vendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i akuzuari lidhur me veprën penale e cila i vihet në barrë sipas kësaj aktakuze, ngase konsideroj se pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga i akuzuari dhe se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, i cili pranim është mbështetur në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e kësaj lënde, dhe nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e vërtetoi para se gjithash nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, pranim i cili ishte i vullnetshëm dhe i mbështetur në të gjitha pikat e aktakuzës, si dhe nga provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës në raport me të akuzuarin, siç ishin, mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore i dt. 26.05.2019, fotodokumentacioni si dhe nga shkresat tjera te lendes, andaj gjykata duke u bazuar në provat e cekura si më lartë të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të gjendjes faktike të pakontestueshme, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1, pika 1.4 të KPRK-së, ngase i njëjti me dt.27.07.2018, rreth orës 00:45 minuta, në S., në Rr." S.", i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit D.D., në atë mënyrë që për shkak të grindjes në lokalit afarist-kafenen "A.", në të cilën i dëmtuari ka punuar si kamarier, e ka pritur të njëjtin pas përfundimit të ndërrimit është nisur për në shtëpi në këmb e i ka dal përpara me automjetin e tij të markës " BMW" të rexhistrimit gjerman, ka hipur në trotuar dhe e ka goditur me retrovizor, e pastaj ka dal nga automjeti e ka marr një shufër metalike dhe ka filluar që me të njëjtën ta godas të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit, kokës, në duar por ka ndërhyrë A.T. i cili i ka ndarë, e i dëmtuari me këtë rast ka pësuar lëndime të lehta trupore në forme të ndryshme të indeve të buta të kokës dhe shpinës si dhe plagë shqyese në tepen e kokës nga ana e majtë të cilat paraqesin pengës të përkohshme për shëndetin, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 73 të KPRK-së, e në rastin konkret për të akuzuarin si rrethanë lehtësuese gjeti faktin se i njëjti gjatë shqyrtimit fillestar e pranoi në tërësi fajësinë lidhur me aktakuzën e cila i vihej në barrë me çka gjykatës i ndihmojë në masë të madhe në vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, gjithashtu rrethanë lehtësuese gjykata gjeti sjelljen e tij korrekte në gjykatë, pastaj moshën e tij të re në kohën kryerjes së veprës penale atëherë ishte 20 vjeçare, ndërsa rrethanë rënduese për të njëjtin gjykata gjeti mënyrën e kryerjes së veprës penale.

Gjykata në këtë çështje penale vendosi që të aplikojë dispozitat e zbutjes së dënimit nga neni 75 dhe 76 par.1 pika 1.7 të KPP-së, ngase konsideroi së ekzistojnë rrethana veçanërisht lehtësuese siq ishin pranimit i fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, pastaj mosha e tij e re në kohën e kryerjes së veprës penale dhe premtimi i të akuzuarit në shqyrtim fillestar së ai nuk do t'i përsërisë veprimet e tilla.

Andaj, gjykata duke u bazuar në rrethanat e cekura si më lartë të akuzuarit i shqiptojë dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar D.D., nga fshati K., Rr. "T.", komuna e S.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 parag.1 dhe 2 pika 2. 6 lidhur me nenin 453 parag.1 dhe 2 të KPP-së.

Nga si u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA SKENDERAJ
- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.433/2019, dt.17.10.2019

Procesmbajtësja
Aferdita Isufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mentor Hajraj

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit, përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit në Prishtinë.